



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 35
Prishtinë, 17 mars 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.

Munguan: Nurishahe Hulaj dhe Slobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në vazhdim: MPMS): z. Nenad Rašić- ministër.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati.

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Nga KDI: Rrezarta Ahmeti.

Nga OSBE: Lejla Selimi.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Nenad Rašić;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar me vërejtjet e deputetes Qamile Morina.

3. Takimi me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Nenad Rašić

Sadik Idriz - Tha se Komisioni në bazë të planit të punës e ka ftuar në takim ministrin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Në ftesë janë caktuar pikat, për të cilat Komisioni është i interesuar të diskutojë me ministrin: informatë për statistikën e të punësuarit dhe të papunësuarit (politikën e MPMS-së për punësimin); angazhimet e Ministrisë për zbatimin e planit të mijëvjeçarit (lufta kundër varfërisë); realizimi i politikave të punësimit për vitin 2008 dhe ç'është planifikuar për vitin 2009; sa po zbatohet skema sociale (a është rritur apo është zvogëluar numri i shfrytëzuesve)?; gjendja e ligjeve (ku ndodhen në procedurë Ligji për punën dhe Ligji për sigurimet pensionale)?; prioritetet (cilat prioritetë të përcaktuara nga MPMS-ja për vitin 2008 janë realizuar dhe cilat janë prioritetet e MPMS-së për vitin 2009)? Hapi diskutimin.

Nenad Rašić- ministër i MPMS-së – Përgjigjet më të hollësishme, për çështjet e shtruara për diskutim nga Komisioni, do t'i dërgojë me shkrim.

Sipas statistikave zyrtare që ka MPMS-ja, në shëndetësi përqindja e punësimit është 43%. Ka shumë organizata që nuk janë të regjistruara dhe nuk mund ta dimë saktë sa janë të punësuar. Nuk kemi ndonjë pasqyrë reale për numrin e të papunësuarve. Nga 333 mijë të papunësuar, 143 mijë janë të rinj, të moshës 25 – 30 vjeç. Nga ky numër 200 mijë janë të pakualifikuar. Kapacitetet e MPMS-së për aftësimin e këtyre janë shumë të vogla dhe me këto kapacitete mund t'i aftësojmë vetëm 2% të këtyre punëkërkesve të pakualifikuar. Në tërë territorin e Kosovës i kemi tetë qendra të aftësimin. Gjysmë të kualifikuar janë 13 mijë e 400 punëtorë, ndërsa me shkollë të mesme 81 mijë. MPMS-ja do të ketë programe aftësimi, do të organizojë edhe hock kualifikime për grupe të grave. Deri më tani kemi aftësuar një numër të caktuar të punëtorëve, që janë punësuar. MPMS-ja ka arritur t'i punësojë 44 mijë punëtorë. Gjatë periudhës 2002 - 2008 i kemi aftësuar 20 mijë punëtorë në bashkëpunim me qendrat tona dhe me qendrën *Don Bosko*. Problemi qëndron te buxheti. Në fondin për aftësimin e punëtorëve kemi vetëm 100 mijë euro. Ky është një buxhet shumë i kufizuar. Kemi Planin për zhvillimin strategjik në Departamentin e Punësimit – këtë plan Komisioni do ta marrë në formë të shkruar. Kryesisht projektet që tash do t'i realizojë MPMS-ja, i bën në bashkëpunim me UNDP-në, siç janë: Projekti që vazhdon dhe përfshin 440 punëtorë dhe Projekti për dërgimin e studentëve për punë të përkohshme në Gjermani, etj. Projekti i punësimit publik është projekt i vitit 2008. Në bashkëpunim me donatorë të jashtëm janë aftësuar 350 punëtorë. Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë janë punësuar 830 veta.

Prioritetet për vitin 2009 do të vazhdojnë. Vitin e kaluar kam bërë kërkesë në Bashkësinë Evropiane për punësim. Kam kërkuar 5 milionë euro, që kanë të bëjnë me rinovimin e sipërfaqeve publike. Kam marrë një prononcim gojor se ata do ta financojnë këtë projekt. Me një projekt si ky Bullgaria ka arritur ta zvogëlojë papunësinë deri në 5 % .

Buxheti për MPMS-në për vitin 2008 ka qenë 82 milionë, ndërsa për vitin 2009 është 159 milionë. Edhe pse buxheti është shtuar, krahasuar me vitin e kaluar është shtuar gati dyfish, MPMS-ja e ka shtuar shumën e pensioneve për 5 euro. Kemi bërë kursime të ndryshme dhe kemi ndërtuar banesa për rastet sociale, si në Skenderaj, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë dhe kemi ndërtuar shtëpinë për të moshuar në Graçanicë etj. E kemi menaxhuar mirë buxhetin. Kemi mjete që i kemi kursyer dhe kemi bërë investim që ka ndikuar në përmirësimin e jetës sociale në Kosovë. Një prej prioritetëve dhe

hapave që kjo ministri po ndërmerr, është krijimi i një “*letre të bardhë*”, me të cilën përcaktohen pikat më të dobëta, ku dhe në ç’drejtim mund të intervenohet. Ky është një dokument strategjik për të cilin insistuan Banka Botërore dhe subjektet e tjera të rëndësishme.

Së bashku me ministrinë e tjera dhe me Bankën Botërore, kemi filluar procesin për një punësim të qëndrueshëm. Banka Botërore e financon këtë me 60 milionë euro. Plani do të bëhet nga të gjitha ministrinë. Një nen i këtij plani është edhe Ligji për punën. Sugjerimi i faktorit ndërkombëtar është shumë i rëndësishëm. Meqenëse planifikojmë të integrohemi në Evropë, duhet t’i analizojmë dhe t’i harmonizojmë disa standarde me Evropën.

Sa i përket skemës sociale, jemi shumë fleksibilë. Po t’i përmbaheshim Ligjit, do ta kishim një numër shumë më të vogël të përfituesve. Kemi një numër shumë të madh të të pakënaqurve. Do të bëjmë zvogëlim jo aq të dukshëm të shfrytëzuesve të skemës sociale, duke i eliminuar ata që nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk kanë nevojë për ndihmë sociale. Kjo do të bëhet në mënyrë graduale. Prej periudhës 2008 e kemi zvogëluar numrin e shfrytëzuesve për 1900. Problemi është se në disa komuna kemi ngritje enorme të shfrytëzuesve. Kjo çështje duhet të ndërpritet, sepse nëse vazhdon kështu ka rrezik që në dhjetor të mbesim pa buxhet. Nëse komunat nuk u përmbahen detyrimeve të veta, kompetenca mund t’i kthehet Ministrisë. Por, nuk është në rregull që Ministria t’i marrë përsëri detyrimet, që tashmë i ka dorëzuar në nivelin komunal.

Ligji për punën është çështje e preokupimit të MPMS-së. Këtë ligj MPMS-ja e ka propozuar në vitin 2008, por për shkak të implikimeve është shtyrë. Tani Ligji është përpunuar përsëri dhe më 25 shkurt ka përfunduar dhe është proceduar. Këtë draft, për ta ndihmuar, ua kemi dërguar Agjencisë Evropiane, Bankës Botërore dhe USAID-it dhe organizatave të tjera. Me 15 prill do përfundojnë të gjitha komentimet e këtij ligji. Ligji për punën është shumë i shtrenjtë, kurse për ta përballuar atë kemi buxhet të kufizuar.

Projektligji për sigurim pensional dhe invalidor kushton 61 milionë euro. Vlerësohet se shpenzimet shtesë do të jenë rreth 20 milionë. Vitin e kaluar ky ligj ka qenë në diskutim, por nuk ka pasur mjete dhe nuk është miratuar. Sugjerimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar ka qenë: *nëse e miratojmë këtë ligj, do të kemi probleme të vazhdueshme me buxhetin*. Presim që Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të ndikojë në zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij projekti.

Në vitin 2008 kemi arritur ta organizojmë një sistem stabil të funksionalizimit, që t’i shfrytëzojmë mirë fondet tona dhe të kemi suficit të vogël. Me rëndësi është arsimimi. Kemi filluar me projekte për punësim. Kosova nuk do të jetë në gjendje ta absorbojë një numër kaq të madh të të rinjve. Shtetet janë të interesuara që të punësojnë punëtorë stinorë, si: Franca dhe një agjenci amerikane që do të paraqesë kërkesë për punësim në bazat amerikane etj. Është vlerësuar se 200 mijë të rinj, do të presin në listën e të papunëve. Nëse tash krijojmë bazën për marrëdhënie me botën, se jemi të vlefshëm, punëtorë dhe të sinqertë, do të kemi perspektivë.

Sadik Idriz – Tha se e kemi një vit të vështirë sa i përket ekonomisë. Ndoshta Kosova nuk do të jetë e goditur në atë masë si disa shtete. Numri kaq i madh i të papunësuarve është problem, po ashtu problem është decentralizimi, sepse ekziston rreziku për ngritje të numrit të shfrytëzuesve, sidomos për përfitime politike në kohën e zgjedhjeve. Sa u përket ligjeve, tha se si Komision, partner e kemi Sindikatën, që mund të ndërhyjë në këto dy ligje. Shpeshherë kjo nuk varet as nga ne. Ne mund ta krijojmë një ligj, por FMN-ja nuk lejon, sepse ka implikime buxhetore. FMN-ja është për të na ndihmuar për të mbajtur balancë financiare.

Mimoza Ahmetaj – Tha se Ligji për skemën sociale është amendamentuar në vitin e kaluar. Në strategjinë legjislativë është paraparë që ky ligj të procedohet përsëri për plotësim dhe për ndryshim. Cilat janë problemet në të cilat ka hasur MPMS-ja, meqë është kthyer ky ligj?

Shqipëria ka një skemë sociale aktive, sipas së cilës të gjithë ata që marrin ndihmë sociale në një formë punojnë. Kjo do të ndikonte tek ata që kërkojnë ndihmë sociale.

Saktësisht sa për qind e buxhetit shfrytëzohet për skemën sociale? MPMS-ja ka hartuar plane e programe për të pakualifikuarit. Ç'ka bërë Ministria për të kualifikuarit që presin në listat e të papunëve? A ka ndonjë plan-program apo strategji konkrete?

Rita Hajzeraj- Tha se 200 mijë punëtorë janë të pakualifikuar. Janë ndarë 100 mijë euro për kualifikimin e punëtorëve. Cila është strategjia e MPMS-së që këta 200 mijë punëtorë të aftësohen për punë? A keni paraparë alternativa të tjera për rritjen e fondeve për kualifikim të këtyre njerëzve? Krijimi i “*letrës së bardhë*” - domethënë identifikim i problemeve. Sa do të zgjasë ky identifikim, duke u nisur nga fakti se problemet tashmë janë të njohura? Strategjia legjislative e Qeverisë ka paraparë procedimin e Ligjit për punën dhe të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor. Nëse mungesa e fondeve dhe kushtetutshmëria e këtyre ligjeve krijojnë probleme, pse janë futur në strategji legjislative?

Gjylnaze Sylja – Tha se punësimi stinor nuk është politikë afatgjate dhe e qëndrueshme. A ka MPMS-ja, politika afatgjate dhe strategji afatgjatë? Cilat janë ato politika? Punësimi stinor paraqet rrezik për popullatën e re, sepse të rinjtë ikin nga Kosova për të jetuar dhe për të punuar në Perëndim. A e ka paraparë MPMS-ja këtë rrezik dhe a ka paraparë masa mbrojtëse? Sa ka përfituar MPMS-ja në Konferencën e Donatorëve? Sa është shuma e fituar dhe me cilat projekte? Nëse një ligj kushton 150 milionë dhe këtë e di MPMS-ja, duhet ta ndryshojë konceptin. Duhet të analizohet se çka mund të realizohet. Ndoshta ky ligj mund të realizohet me 20 milionë? A po punon në këtë aspekt Ministria? Ligji për punën është paraparë të procedohet për miratim në qershor. Kur planifikohet që Ligji për sigurim pensional të procedohet në Kuvend? A ka bashkëpunim ndërministror për zgjidhjen e problemit të papunësisë, sidomos me MEF-in dhe me MASHT-in? A ka ndonjë plan për rritje ekonomike dhe për zvogëlimin e papunësisë?

Armend Zemaj – Ç'ka bërë MPMS-ja, konkretisht Inspektorati i Punës, për të drejtat e punëtorëve të sektorit privat, në të cilin punëtorët nuk gëzojnë asnjë të drejtë, sepse punojnë me orar të zgjatur, pa kurrfarë sigurimi etj? Punëdhënësi e keqpërdor këtë gjendje dhe i largon pa të drejtë punëtorët nga puna.

Teuta Hadri – Tha se kur ka dëgjuar se ministër i MPMS-së është një person nga radhët minoritare në Kosovë, konkretisht nga minoriteti serb, ka menduar se problemi i pensioneve deri në vitin 1999 do të zgjidhet. Ç'ka bërë konkretisht ministri, që paratë e pensioneve, të mbrojtura me të gjitha konventat ndërkombëtare, të kthehen në Kosovë?

Në mandatet e kaluara, ajo së bashku me deputeten Flora Brovina, kanë bërë presion që përfaqësuesit e Trustit të vijnë në Komision për t'i bërë politikat më të qarta. Përfaqësuesit e Trustit kanë garantuar se paratë janë të sigurta. Çka ka ndërmarrë MPMS-ja, që paratë e Trustit Pensional të kthehen në Kosovë? Me sukses është realizuar Projekti i punësimit të punëtorëve stinorë në Francë. Sa është numri i këtyre punëtorëve dhe a është shtuar ky numër?

Qamile Morina – Sa është implikimi buxhetor për Ligjin e Punës? Meqë Ligji i punës është ripunuar, ç'ka ndryshuar MPMS-ja në Ligjin e tanishëm, në krahasim me atë që ka qenë i proceduar në vitin e kaluar? A konsideron MPMS-ja, se tani Ligj do të përkrahët nga organizatat ndërkombëtare? Problem lidhur me Ligjin e punës nuk është implikimi buxhetor, por mungesa e sistematizimit dhe e krijimit të sistemit. MPMS-ja ka buxhet prej 159 milionë eurosh. I ka 100 mijë euro për trajnime, që po tregohen të suksesshme. Ata që MPMS-ja po i trajnon 12 muaj, po arrin t'i punësojë. MPMS-ja ka investime të mëdha kapitale. Në *websajtin* e MPMS-së figuron vlera prej 4 milionë e 700 e 4 mijë eurosh për renovimin e Nashecit (Qendra për Fëmijë). Përderisa MPMS-ja e konsideron të rëndësishme rritjen e punësimit, a ka kuptim të rinovohet ky objekt, me këtë shumë kaq të madhe parash, kur shuma për trajnime është vetëm 100 mijë euro? Në përgjithësi vendit tonë po i mungon krijimi i prioritetëve.

Ndoshta do të mund t'i ndihmonte Kosovës kërkesa për pranim në Organizatën Ndërkombëtare të Punës, në të cilën mund të jeni anëtarë nëse pajtohet 2/3 e kësaj organizate. Ligji për skemat sociale është ligj bizar dhe jep mundësi për mashtrime. Mashtrimet nuk ka vetëm në Kosovë, por në të gjitha vendet në transicion. Çdo shtet, për ta luftuar mashtrimin, duhet ta krijojë bazën e të dhënave. Ky projekt duhet të realizohet me Bankën Botërore. Prioritet yni duhet të jetë që në këto skema sociale të zvogëlohen mashtrimet dhe ndihmë sociale të marrin vetëm ata që me të vërtetë kanë nevojë. MPMS-ja ka bërë një memorandum me organizatat joqeveritare për të drejtat e fëmijëve (kosovar-evropian). Ky projekt është për parandalimin dhe trajtimin e narkomanëve. Ç'ka arritur MPMS-ja të bëjë nga momenti i nënshkrimit të këtij memorandumimi?

Flora Brovina – Si mund t'i punësojmë punëtorët stinorë, përderisa nuk i kemi Ligjin për sigurimin shëndetësor dhe Ligjin për pensionet. Disa institucione kanë filluar që këto sigurime t'i bëjnë në formë private. A është studiuar në MPMS, se cilat janë mundësitë e punësimit brenda Kosovës? Lidhur me projektin që është zbatuar në Bullgari, tha se e ka të njohur atë projekt që është zbatuar me shoqatat e grave. A jeni në kontakt me Komisionin për Çështje Sociale në Parlamentin Evropian? Vendet në transicion e kanë të deleguarin e vet për çështjen e punësimit.

Bujar Bukoshi – Tha se MPMS-ja e ka një buxhet të kufizuar. Ky është një realitet i hidhur. Përkrah mendimin të hartohet një listë e prioriteteve. Do të dështojmë përderisa nuk kemi listë të prioriteteve. Trustit Pensional është një skandal i përhershëm. Çështja e shumës së parave është shumë me rëndësi. Shoqëria, sidomos Qeveria, duhet të jetë e organizuar. E inkurajoj ministrin se do ta ketë përkrahjen e Komisionit.

Nenad Rašić- ministër i MPMS - Tha se problem i MPMS-së, është buxheti i kufizuar. Në njërin nga mbledhjet e para me Bankën Botërore është kërkuar të theksohen prioritetet e Qeverisë. Ndër prioritetet janë sigurimi i punësimit të qëndrueshëm dhe infrastruktura. Bazën e të dhënave në Ministri, që e rregullon çështjen e ndihmave sociale, duke eliminuar çdo mënyrë të manipulimeve të ndryshme, e kemi instaluar 15 ditët e kaluara.

Skema sociale përfshinë 97% të buxhetit dhe kemi mundësi shumë të kufizuara për çështje të tjera. Këtë vit kemi investime kapitale prej 2 milionë e 400 mijë eurosh. Qendrat për ndihmë duhet të formohen në çdo komunë, por nuk kemi arritur të bëjmë këtë. Kemi zyrat rajonale të punësimit dhe në vitin e kaluar kemi punësuar 5 mijë e 60 punëtorë nëpërmjet enteve të punësimit. Ne i stimulojmë punëdhënësit. Shumë herë kemi biseduar me ministrin e Arsimit, në mënyrë që lokalet e shkollave, në kohën kur ato janë të lira, t'i shfrytëzojmë për trajnime ad hoc. Bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Tregtisë, jemi përfshirë në një program të Bankës Botërore, që disa nga donacionet, t'u kushtohen aftësimeve profesionale gjatë verës. “*Letra e bardhë*” do të jetë e gatshme këtë javë. Organizatat ndërkombëtare do ta vlerësojnë atë dhe do ta kthejnë prapë në MPMS. Ky projekt do të jetë udhëzues themelor për problemet e punësimit. Ligji për punën do të ketë implikime 14 milionë euro, kurse implikimet shtesë do të jenë 7 milionë.

Jemi në përfundim të Ligjit për pensione. Me kërkesë të FMN-së rezervat e Kosovës për shkak të krizës ekonomike duhet të jenë 200 milionë. Mjetet e ndara nga Konferenca e Donatorëve ende nuk i kemi marrë. Kjo ndihmë mund të jetë rreth 30 milionë eurosh. Sa i përket pyetjes për të drejtat e punëtorëve, MPMS-ja, Inspektorati i Punës - në periudhën shtator - nëntor 2008, ka ndërmarrë një aksion. Shkonte te të gjithë punëdhënësit që të njoftoheshin se nga 1 nëntori do të fillohej në mënyrë të prerë me zbatimin e Ligjit. Prej një nëntorit kemi filluar me kontroll të përpiktë dhe jemi njoftuar se shumë punëdhënës kanë bërë problem me inspektorët e punës. Disa prej tyre janë dënuar për mosrespektimin e Ligjit sa i përket sigurimit në punë.

E kemi miratuar Rregulloren për dënimet e punëdhënësve në rast të mosrespektimit të Ligjit për mbrojtje në punë.

Sa u përket pensioneve që kanë të bëjnë me Serbinë - në këtë drejtim nuk ka asgjë konkret. Unë do të punoj në favor të shoqërisë kosovare.

Sa i përket projektit të Nashecit, për rindërtimin e këtij objekti të vjetër, kemi harxhuar 400 mijë euro (jo 4 milionë). Problemi është për çka do të shfrytëzohet ky objekt? Nuk mund të punësojmë njerëz, sepse nuk kemi ligj. Nuk dimë se kush do ta udhëheqë apo kush do ta menaxhojë Qendrën. Sa i përket anëtarësimit në ILO, jemi në proces të anëtarësimit.

Gjylnaze Syla – Pyeti se për cilën periudhë janë paraparë 60 milionë të Bankës Botërore. Pse Inspektorati i Punës po funksionon si Agjenci, përderisa me Ligj është paraparë të jetë inspektorat?

Nenad Rašić- ministër i MPMS – Tha se ky ishte problem dhe vendimi si është marrë ishte kontradiktor. Kryeministri i mëparshëm ndoshta është ngutur me këtë vendim. Kjo është specifike. Duhet t'i sqarojmë çështjet brenda Ligjit, sepse disa sosh janë në kundërshtim me të.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – Njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me përfaqësuesit e Organizatës Friedrich Ebert Stiftung. Takimi do të mbahet në orën 13:30, posa të ketë përfunduar mbledhja e rregullt e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Sadik Idriz